



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 4038/prot.

Tiranë, më 05.07.2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1610, datë 23.01.2013.

**SHOQËRIË “VËLLAZËRIA” SH.P.K
Rreth Rrotullimi “Zogu i Zi”, Kompleksi “Karl Topia”,
Kulla e III-të, Kati II-të, Tiranë.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “Vëllazëria” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1610, datë 23.01.2013, për mineral kromi, në objektin “Gajrep”, Bashkia Has, Kukës.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.2607, datë 08.04.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.4038 datë 10.04.2019, është propozuar revokimi i lejes nr.1610, datë 23.01.2013, për mineral kromi, në objektin “Gajrep”, Bashkia Has, Kukës, sepse nuk keni paguar garancinë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitet 2014 – 2015, 2015 - 2016, 2016 – 2017, 2017 – 2018, 2018 - 2019, duke mos respektuar kërkesat e nenit 31 të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve, është i mbështetur në germen “ç” të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1610, datë 23.01.2013, për mineral kromi, në objektin “Gajrep”, Bashkia Has, Kukës, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes shfrytëzimit nr.1610, datë 23.01.2013, për mineral kromi, në objektin “Gajrep”, Bashkia Has, Kukës.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI

